Kronikë

VIDEO/ I gjendet arsenal armësh dhe municioni luftarak në banesë, arrestohet 40-vjeçari në Pogradec! Do t'i trafikonte në Maqedoninë e Veriut

Alti Jasharllari është arrestuar nga policia e Pogradecit pasi i është gjetur një arsenal armës dhe municion luftarak në banesë.

HOROSKOPI

Redaksia
14 Korrik, 15:29 | **Përditesimi: 14 Korrik, 16:04**

Alti Jasharllari është arrestuar nga policia e Pogradecit pasi i është gjetur një arsenal armës dhe municion luftarak në banesë.

Policia thotë se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e 40-vjeçaritnë fshatin Starovë në Pogradec, u gjetën të fshehura një mitraloz i lehtë; një armë zjarri tip automatik; dy pushkë gjysmëautomatike; një sasi e konsiderueshme municioni luftarak; krehëra automatiku, pushke dhe mitralozi; 1 gjerdan mitralozi me 30 fishekë; një granatë dore ofensive; pjesë të lëvizshme të pushkës, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

LEXO EDHE:
Pas suksesit në Tiranë, muzika 'Jazz&Blues' mbërrin nesër në Korçë

Nga hetimet e kryera dyshohet se 40-vjeçari, banues në Starovë në Pogradec, do të trafikonte arsenalin e armëve dhe municioneve luftarake, në drejtim të Maqedonisë së Veriut. Vijon puna për dokumentimin e plotë të këtij aktiviteti të paligjshëm.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: pogradec Korce

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kuvendi i heq imunitetin, a duhet Arben Ahmetaj t'i dorëzohet drejtësisë?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kreu gjashtë vjedhje në dy javët e fundit, arrestohet 30-vjeçari në Korçë! I dënuar edhe më parë për vjedhje
12 Korrik, 13:40



Mbi 180 mësues në Korçë e Maliq ende pa marrë pagat, kreu i Sindikatës: Dje e mora vesh, më thanë ngri zërin se kemi fëmijët pa bukë! Kishin frikë ta bënin publike
12 Korrik, 11:14

Sezoni veror, plazhet pa vëzhgues në Pogradec, privati shkel ligjin! Bashkia: U kemi lënë dy ditë afat, pritet ndërtimi i kullave të vrojtimin në vijën liqenore
Armand Braho
11 Korrik, 16:33

Falsifikuan dokumentet e një aksidenti dhe ia hodhën fajin shoferit tjetër, pezullohen nga detyra 3 punonjës policie në Korçë
11 Korrik, 14:56

Arrestohet 49-vjeçari në Pogradec, ishte i armatosur! I dënuar edhe më parë për armëmbajtje pa leje
10 Korrik, 15:12

Fermerët në Maliq djegin barin për të pastruar tokën, flakët rrezikojnë sipërfaqet me grurë
9 Korrik, 19:24

Tomas Delpier i apasionuar pas gjuhëve të huaja! Psikologu belg njeh 16 gjuhë: Shqipen e mësova nga librat
Armand Braho
9 Korrik, 16:21



FOTO/ Më shumë hapësira publike për pushuesit në Pogradec, qytetarëve u shtohen 7 plazhe me çadra falas
9 Korrik, 12:51

Vendosën muzikë të lartë në lokal mbi orarin e lejuar, nën hetim pronari i lokalit dhe tre muzikantë në Korçë
9 Korrik, 10:08

S'ka bashkim me Tiranën, Kushi: Universiteti i Korçës i ka të gjitha kapacitetet! Do rritet përmes ndërkombëtarizmit dhe profilizimit
8 Korrik, 14:03

Procesi i Berlinit, ambasadori gjerman: Qeveria shqiptare po merr seriozisht organizimin e samitit ne Tiranë! Tregon rëndësinë që ka rajoni
6 Korrik, 12:32

Sekuestrohet varka e peshkimit në liqenin e Ohrit, kryente gjueti të paligjshme
5 Korrik, 18:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Gerbuma

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje